



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 14/8 Prot

Vlorë, më 20.07. 2023.

VENDIM

Nr. 5 , datë 13.07.2023

PËR

**MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR UJË TË
PIJSHËM, TË SUBJEKTIT “BASHKIA HIMARË”, ME VENDNDODHJE: FSHATI
TRAGJAS, NJ.ADM ORIKUM, BASHKIA VLORË, QARKU VLORË**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujqor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujqor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujqor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujqor nëntokësor për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës) në rastin kur përdorimi është > 1 l/sek, të subjektit “Bashkia Himarë”, me vendndodhje: Fshati Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit (KRGJSH):

X= 458427.65

Y= 4465448.51

Z=16 m.m.n.d

Sasia e ujit të kërkuar: $Q_{log} = 141.6$ l/sek

Prurja mesatare vjetore: $Q_{\text{mes-vjet}} = 1800 \text{ l/sek}$

Prurja ekologjike: $Q_{\text{eko}} = 186 \text{ l/sek}$

Lloji aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji. Për ujë të pijshëm (sisteme të furnizimit me ujë të popullatës).

3. Përpara fillimit të shfrytëzimit të burimit për ujë të pijshëm, të merren në konsideratë rekomandimet e Institutit të Shëndetit Publik, si dhe masa për sigurimin e zonës së mbrojtjes sanitare të burimit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETAR
FLAMUR MAMAJ

